

Sintaksë e gjuhës shqipe

1

Njohuri të përgjithshme për sintaksën

- **Objekti i sintaksës**

Sintaksë quhet tërësia e mënyrave të bashkimit në ligjërimit të fjalëve të një gjuhe sipas kuptimit e natyrës gramatikore, bashkë me marrëdhëniet e vendosura midis njësive të formuara prej tyre, me rregullsitë përkatëse, për të shprehur mendimet e për t'ua bërë ato të njohura të tjerëve.

Sintaksa ka për objekt ligjërimitin e lidhur. Nëpërmjet këtyre lidhjeve e raporteve krijohen njësi të ndryshme sintaksore.

- **Njësiti sintaksore**

Njësiti sintaksore të dallueshme janë: *fjalìa, periudha, gjymtyra e fjalisë, togfjalëshi*. Së voni flitet edhe për njësi më të mëdha se fjalìa dhe periudha. Njësia themelore sintaksore, që është mjeti kryesor, mënyra kryesore e formëzimit, e shprehjes dhe e kuptimit të mendimit, është fjalìa.

Fjalìa është fragmenti i ligjërimit i përbërë zakonisht prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara, në bazë të ligjeve të një gjuhe, në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore. Mund të jetë e formuar edhe prej një fjale të vetme me vlerën e një kuptimi. Është njësia më e vogël kuptuese. Fjalìa mund të dalë në vëllime të ndryshme e me skema strukturore të ndryshme:

I flihej. U err. Shiu kishte pushuar. Bukur i këndon këto të shkreta këngë! Thyerja e koncepteve të vjetra është ndoshta shumë më e vështirë se thyerja e një hordhie armike. Shqipëria, dikur një vend i skllavëruar gjysmëkolonial, është sot një vend i lirë, sovran dhe i paprekshëm.

Periudha është njësia e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësish kallëzuesore në formë fjalie, në raporte të caktuara midis tyre. P.sh. *Ishte ende herët dhe bënte freskët. Thellë gumëzhinte lumi i Devollit, që ish bymyer nga shirat.*

Togfjalësh quhet njësia strukturore e formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve të plotkuptimshme në raporte të caktuara kuptimore e gramatikore midis tyre. P.sh. *Kishte hyrë vjeshta e tretë.* Vuante nga *mëlqia e zezë.*

Gjymtyrë fjalie quhet fjala (ose togfjalëshi) që del si një njësi sintaksore më vete nga funksionimi që përmbush në fjali. Të tilla janë fjalët kuptimplota, vetëm ose të shoqëruara me fjalë shërbyese, të vështruara nga raportet kuptimore e gramataikore që i lidhin ato me fjalë të tjera (nuk flitet në këtë mënyrë)

- **Mënyrat e mjetet e shprehjes së raporteve sintaksore**

Midis njësive të ndryshme sintaksore vendosen raporte të ndryshme.

Dallohen dy kategori të mëdha raportesh sintaksore: **raportet e barazisë, të pavarësisë**, në të cilat njësitë e vëna në lidhje midis tyre qëndrojnë në të njëjtin rrafsh pa u varur njëra prej tjetrës, dhe **raportet e varësisë**, në të cilat njësitë e bashkuara qëndrojnë në rrafsh të ndryshme, varen njëra prej tjetrës. Të dyja këto kategori i gjejmë si në fjali midis gjymtyrëve, si në periudhë midis fjalive.

P.sh.: Atje tej dëgjohej hingëllimi **i dëshpëruar, i ngjirur, i këputur** i një kali. Në të dy brigjet e lumit sulet **e krajanëve dhe të anamalasve**. (fjali me raporte barazie, pavarësie)

Zjarri kishte marrë mirë **dhe** dhoma e vogël e kështjellës ishte e ngrohtë e plot dritë. (periudhë me raporte barazie, pavarësie)

Sytë e tij **të qetë** vështronin **me habi këtë skenë prekëse**. (fjali me raporte varësie)

Mua nuk më durohej **gjersa të shikoja Frashërin**. (periudhë me raporte varësie)

Raportet e varësisë në togfjalësh e fjali shfaqen **në forma e me mjete të ndryshme** lidhjeje sintaksore. **Format kryesore të këtyre lidhjeve** sintaksore janë: **përshtatja, drejtimi, bashkimi i thjeshtë a pranëvënia**.

Përshtatje quhet ajo lidhje sintaksore në të cilën fjala e nënrenditur, e varur, shkon me fjalën me të cilën hyn në lidhje, në kategoritë gramatikore që i ka të përbashkëta me të. P.sh.: male të larta, librat e mi, libër i mirë, etj.

Drejtimi është lidhja sintaksore nënrenditëse, në togfjalësh e fjali, në të cilën trajta rasore e fjalës së varur (emër a përemër), për të shprehur këtë ose atë marrëdhënie sintaksore, drejtohet, dhe veçoritë gramatikore ose semantike të fjalës drejtuese, të fjalës me të cilën lidhet, vihet në trajtën rasore të kërkuar prej tyre. P. sh.: Një erë e tërbuar **lufte** solli me vete **ulurimën e pyllit**.

Bashkimi i thjeshtë ose **pranëvënia** karakterizohet nga mospërdorimi i mjeteve morfologjike. P.sh.: Shqiptari s' u mposht **kurrë**. Pse rri **menduar**? Vinte **duke kënduar**.

Për shprehjen e raporteve sintaksore përdoren **mjete të ndryshme** të një natyre të ndryshme:

- a) morfologjike: trajtat e fjalëve ose eptimi (fleksioni). Kryefjala shprehet me emër a përemër në rasën emërore, kundrina e drejtë me emër a përemër në rasën kallëzore, kundrina e zhdrejtë me emër a përemër në rasën rrjedhore ose në rasën kallëzore me parafjalë etj.
- b) sintaksore: fjalët ndihmëse a shërbyese (lidhëza a parafjalë) ose fjalët lidhëse (përemra e ndajfolje) e bashkimi ndërmjet tyre; paravënia a parataksa asindetike (bashkimi i thjeshtë, joparafjalor e jolidhëzor) dhe topika a rendi:
- c) fonetike: intonacioni;